



PRANUAR ME: 22.11.2023  
ACCEPTED ON:  
PRIMLJENO:  
Mr.No.Br. 07/269



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS  
Drejtoria e Inspektoratit

DATE	22/11/2023
PËR :	Ekrem KASTRATI, Kryetar i Komunës
NGA :	Hafir REXHA, Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit
LËNDA :	Planifikimi i punëve për vitin 2024



*I nderuar,*

*Keni të bashkangjitur Planifikimin e punës dhe detyrave të përgjithshme të Drejtorisë së Inspektoratit për vitin 2024.*

Malishevë, nëntor 2023

## **DREJTORIA E INSPEKTORATIT**

---

**Sektorët të cilët janë në Drejtorinë e Inspektoratit.**

- 1. Shefi i Drejtorisë**
  - 2. Inspektimi në sektorin e ndërtimit**
  - 3. Inspektimi në sektorin e tregtisë**
  - 4. Inspektimi në sektorin komunikacionit**
  - 5. Inspektimi në sektorin e shërbimeve publike**
  - 6. Inspektimi në sektorin e mjedisit**
-

## DREJTORIA E INSPEKTORATIT

---

### Planifikimi i Punëve të Përgjithshme për vitin 2024

- Gjatë vitit 2024 Drejtoria e Inspektoratit planifikon të kryej këto punë të parapara sipas ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Inspektimin e përgjithshëm të terrenit në tërë territorin e Komunës së Malishevës.
- Pjesëmarrjen e zyrtarëve në komisione për ndryshme dhe plotësimin e Rregulloreve të sektorit të drejtorisë sonë si dhe të sektorëve tjerë.
- Shqyrtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të natyrave të ndryshme të parashtuara nga qytetarët e Komunës së Malishevës.
- Inspektimin e ndërtimeve , në veçanti të ndërtimeve pa leje ndërtimore, parandalimin e ndërtimit të tyre.
- Kontrollimin e ndërtimeve me leje ndërtimore, inspektimin e të gjitha fazave të ndërtimit , dokumentacionit përkatës, se a është duke u ndërtuar sipas lejes ndërtimore të lejuar.
- Inspektimin e të gjitha objekteve që rrënohen.
- Inspektimin e kushteve dhe masave të sigurisë që kanë të bëjnë me sigurimin e objektit dhe ambientit përreth objektit në ndërtim e sipër.
- Kontrollimin e ambientit në përgjithësi dhe eliminimin e pikave ilegale grumbulluese të mbeturinave komunale edhe inerte
- Kontrollimin e ndotjes nga ujërat e zeza në përgjithësi si dhe hedhjen e mbeturinave sidomos në pronat publike.
- Kontrollimin e fabrikave të betonit si dhe gurthyesve të cilët veprojnë-operojnë në territorin e Komunës së Malishevës, lidhur me masat mbrojtëse për ruajtjen e ambientit.
- Kontrollimin e furrave gëlqerore, në territorin e komunës sonë tashmë janë shumë pak (2-3)
- Kontrollimin e të gjithë Auto Serviseve , Autolarjeve, deponive të automjeteve të vjetra .
- Inspektimin e përgjithshëm të Lejeve Mjedisore Komunale.

## DREJTORIA E INSPEKTORATIT

---

- Inspektimin e përgjithshëm të hapësirave publike (rrugëve, trotuareve, shesheve, varrezave, shëtitoreve)
  - Inspektimin e hapësirave publike të institucioneve publike (shëndetësore, arsimore)
  - Inspektimin dhe mbikëqyrjen e kompanive publike, atë për mirëmbajtjen e pastërtisë. grumbullimin e mbeturinave në qytet dhe nëpër fshatra , për mirëmbajtjen dhe pastrimin e pusetave dhe rrjetit të kanalizimit.
  - Kontrollimin e përgjithshëm të subjekteve afariste për regjistrimin e subjekteve afariste (vërejtje me gojë si dhe me shkrim).
  - Kontrollimin e të gjithë sektorit të gastronomis-restauranteve si dhe dyqaneve tjera të specializuara në Komunën e Malishevës.
  - Kontrollimin e subjekteve-marketeve për mallra për afat të skadences, për deklaracion të mallit, konfiskimin dhe asgjësimin e mallit (së paku 4 herë në vit, Mars-Korrik-Shtator-Dhjetor)
  - Kontrollimin e orarit të punës për subjektet afariste për barnatoret të cilat janë kujdestare si dhe për subjektet tjera të natyrave të ndryshme.
  - Kontrollimin e përgjithshëm të tregjeve javore ( autotregun, tregun e gjelbert dhe te shtazëve)
  - Kontrollimin e pikave të karburantit për kalibrim të aparaturave të tyre.
  - Parandalimin e shitjeve të mallrave jashtë vendit të destinuar si në lokale afariste ashtu edhe të tregtarët ambulator.
  - Kontrollimin e furrave të bukës për cilësi (aditiv) dhe peshë të deklaruar të bukës.
  - Fokus të veçantë kontrollimin e lokaleve që kryesisht frekuentohen nga të rinjtë për parandalimin e konsumimit të duhanit dhe alkoolit.
  - Dhënien e Pëlqimeve për plotësimin e kushteve teknike minimale për të gjitha subjektet afariste, që merren me tregti me pakicë dhe shumicë.
- 
- Marrja pjesë në komisionin për ndarjen e vijave urbane për kompanitë transportuese.
  - Inspektimin dhe kontrollimin për mirëmbajtjen e vijave të lejuara urbane nga kompanitë transportuese.
  - Inspektimin e Taxi-ve, autotransportuesve, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë nga kombitaxit.

## DREJTORIA E INSPEKTORATIT

---

- Të gjitha parregullsitë e shfaqura si nga personat fizik (qytetarët) ashtu edhe nga subjektet afariste përkatësisht nga personat përgjegjës të subjekteve afariste në rast të shkeljeve eventuale të dispozitave ligjore dhe rregulloreve komunale evidentohen dhe dërgohen të gjitha lëndët për dënim në organet kompetente për ndëshkimin e veprimeve kundër ligjore.
- Drejtoria e Inspektoratit në shumë raste do bëjë inspektime të ndryshme në bashkëpunim me inspektorët regional dhe ata qendrorë të të gjitha lëmive.
- Drejtoria e Inspektoratit në vazhdimësi do të ketë bashkëpunim shumë të mirë me Policin e Malishevës për të gjitha rastet e asistimit dhe procedurave tjera .
- Këto detyra dhe përgjegjësi do të kryhen gjatë inspektimeve të Rregullta të planifikuara si dhe inspektimeve të Jashtëzakonshme.
- Këto punë dhe detyra te punës përveç ditëve të rregullta të punës do bëhet inspektime edhe gjatë ditëve të vikendit.

**-Për shkak të specifikave të punës në drejtorin tonë , të gjitha këto detyra të lartcekura dhe detyrat tjera bëhen gjatë gjithë periudhës së vitit në çdo ditë dhe çdo muaj në vazhdimësi.**

---

Me respekt ,